

# JEMI NJË





## FORMA E QEVERISJES NË KOSOVË

EGZON (12), MAJLINDA (12), ARION (11), ERITA (12), JETMIR (11), ERMIRA (12), ADEM (11), GENTIJAN (11)



**Ne nxënësit e klasës VI-4 të shkollës „Zenel Hajdini“, sot kemi mësuar për mënyrën se si funksionon demokracia, cilat janë format e saj dhe shumë gjëra të tjera**

Ne qytetarët e Republikës së Kosovës kemi të gjithë të drejta të barabarta, pa asnjë dallim. Edhe pse ne nuk kemi qenë në kohërat e vjetra për të parë se si ishte demokracia dhe kushtet në atë kohë, ne dijmë se tani kushtet janë më të mira se në kohët e vjetra.

Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Po ashtu, demokracia ka lindur në Greqi në vitin 507 para erës së re.

Disa nga elementet kryesore të demokracisë janë: respekti, toleranca, barazia, liria, të drejtat e njeriut etj. Ekzistojnë shumë forma të demokracisë, por dy prej tyre janë më të përhapura e ato janë: e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese.

Sistemet e demokracisë përfaqësuese janë: sistemi parlamentar dhe ai presidencial. Sistemi parlamentar funksionon në Kosovë. Për të zgjedhur deputetët duhen votat e qytetarëve.

Deputetët kanë një punë shumë të rëndësishme dhe të lodhshme, sepse i votojnë projektligjet për të hyrë në fuqi, si ligje.

Ndërsa, për të zgjedhur Presidentin duhen votat e deputetëve, të cilët vendosin në emrin tonë si qytetarë të këtij shteti.





Sistemi presidencial funksionon më ndryshe se ai parlamentar, sepse qytetarët dalin në zgjedhje për ta votuar përfaqësuesin e tyre, i cili është Presidenti.



**Bashkimi bën fuqinë**




**Autorët e artikullit**





# KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS


ALEJNA (11), ARI (12), AMIRE (11), ARTIN (12), GENC (11), GENTRIT (11), SUAD (11), GENTRINA (11)



## Mësoni më shumë për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe funksionet e tij

Ne jemi klasa VI-4 dhe sot kemi mësuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne po ashtu, jemi gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Pra, jemi përfaqësues të tij. Tani, në artikullin tonë do të mësoni më shumë për Kuvendin dhe rëndësinë e tij. Atëherë, çfarë institucioni është Kuvendi? Kuvendi është institucioni më i lartë demokratik i një vendi. Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë. 100 janë të komunitetit shumicë (shqiptar), kurse 20 i përkasin komuniteteve jo shumicë (romë, ashkalinjë, egjiptas, boshnjak, turq dhe serb). Deputetët zgjedhen nga populli me anë të votës. Kjo do të thotë se deputetët nuk do të ishin deputetë pa votën tonë. Prandaj, deputetët kanë për detyrë të na përfaqësojnë neve në mënyrë të denjë. Kuvendi i Kosovës ka tri funksione kryesore: funksionin përfaqësues, funksionin kontrollues dhe funksionin legjislativ. Kuvendi ka funksion kontrollues sepse kontrollon Qeverinë. E pse e kontrollon Qeverinë? Sepse Qeveria ka për detyrë të zbatoj ligjet që i dërgon në Kuvend, të cilat fillimisht janë projektligje. E këtu hyn funksioni legjislativ, sepse Kuvendi ka për detyrë të miratoj ose jo projektligjet që dërgohen nga Qeveria në Kuvend. Puna të cilën e bëjnë deputetët ndikon shumë në jetën tonë. Marim shembull një ligj i arsimit apo i shëndetësisë, i cili miratohet nga deputetët do të ndikojë në jetën tonë. Ne mendojmë se

është shumë e rëndësishme se kë e votojmë për deputet sepse ata do të jenë përfaqësuesit tanë. Pasi ta përfundojmë artikullin ne do ta vizitojmë Kuvendin e Kosovës si dhe do të kemi mundësi të ulemi në ulëset e deputetëve. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë.



Akti më i lartë juridik i një shteti - Kushtetuta



Autorët e artikullit

## NDRYSHIMI FILLON PREJ TEJE

MEGZON (11), ELSA (11), EDUART (11), FJOLLA (12), ALBIN (11), ENDI (11), RESA (11), ARLINA (11),  
ARISA (11)

### Zgjedhjet, proces shumë i rëndësishëm në demokraci

Demokracia do të thotë qeverisje nga populli, ku të gjithë kanë të drejtë të shprehen lirshëm. Mirëpo, dikush duhet t'i përfaqësojë ata. Për këtë arsye praktikohen zgjedhjet. Për të kryer këtë proces përdorim votat. Me anë të votave ne zgjedhim përfaqësuesit tanë. Votimet praktikohen në dy mënyra: në votime me lista të hapura dhe të mbyllura. Votimet e mbyllura përdoren nga populli për të zgjedhur përfaqësuesit, në mënyrë që të ruhet vota e secilit.

Ne të gjithë kemi të drejtë për të zgjedhur, mirëpo për të marrë pjesë në zgjedhje duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të vetëdijshëm se për kë të votojmë.


Rëndësia e votave nuk ka çmim, sepse edhe një votë e vetme, bën ndryshim të madh.



Për një të ardhme më të mirë




Zgjedhja është e jotja



Një për të gjithë dhe të gjithë për një



Demokracia, Kosova dhe ne „Demos-ti“



Ti voto!





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Zenel Hajdini“  
Klasa: VI-4  
Vendi: Prishtinë